# DËSHMI ARKIVI

**A-436789**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Klodiana Spahiu merr drejtimin e Shëndetësisë: Objektivi ynë i qartë, transformim i shërbimeve mjekësore – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/klodiana-spahiu-merr-drejtimin-e-shendetesise-objektivi-yne-i-qarte-transformim-i-sherbimeve-mjekesore/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 12:44:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 12:40:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5cf06fa54c0a23afb19e0621ae74c9c642ef053210b3c92bb3328c7dab85690e` |
| TEKSTI | `774fa3c3396600ecfcae4327e819d30c024d37105227de314ca5e54de99a628c` |
| PAMJA | `37cd8d1ae74cb371c158774b4111bf436b27fe24a7d81ab0e88ab4436ee5dcea` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `31bcab4a23965e92dc47622de9ae75ec5655889cfef964abe2eec4396a6e9806` |
| E MËPARSHMJA | `acdd9c449736509860ae596f78d2f2c53e201f5bb9b8fac68dd88f09f29245c2` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/31bcab4a23965e92dc47622de9ae75ec5655889cfef964abe2eec4396a6e9806`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Me betimin mbi Kushtetutë Ministrja Klodiana Spahiu mori zyrtarisht detyrën e drejtimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në shërbim të qytetarëve dhe interesit publik.

Ndërsa shprehu një falenderim të veçantë për kryeministrin Edi Rama dhe paraardhësen, profesoreshën Evis Sala për punën dhe përkushtimin në drejtimin e kësaj ministrie, si dhe të gjithë stafin që ka bashkëpunuar me të, Spahiu u zotua se do të vijojë të përmbush reformat me qëllim transformimin sa më të shpejt të shërbimit shëndetësor.

*“Objektivi ynë është i qartë: transformimi i shërbimeve mjekësore, përmirësimi i infrastrukturës spitalore, rritja e cilësisë dhe aksesit në shërbimet shëndetësore dhe sociale, duke vendosur gjithmonë qytetarin në qendër të çdo politike dhe vendimmarrjeje. Marrja e kësaj detyre përkon edhe me nisjen e një Sesioni të ri parlamentar, në një moment të rëndësishëm për Shqipërinë, kur jemi më pranë se kurrë objektivit tonë madhor: anëtarësimit në Bashkimin Evropian”,* shkroi ministrja Spahiu në Facebook, ndërsa theksoi se do të vijojë punën me përgjegjësi dhe besimin se do të përmbush misionin e saj jo vetëm si drejtuese por dhe si mjeke.

*“E marr këtë detyrë me shumë përgjegjësi, por edhe me besimin se mund të kontribuoj për të çuar më tej punën dhe reformat e ndërmarra në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.*

*Shëndetësia ka qenë gjithmonë një fushë me të cilën kam qenë dhe mbetem shumë e lidhur. Prandaj, kjo detyrë për mua nuk është thjesht një përgjegjësi e re, por një mision dhe një ambicie për të vijuar me energji*

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

*rrugën e reformave"*, nënvizioi ministrja.

Spahiu tha se me përkushtim, përgjegjësi dhe punë do të vijojë ky rrugëtim për një sistem shëndetësor modern, cilësor, të aksesueshëm dhe dinjitoz për çdo qytetar.

**/vizionplus.tv**

#KlodianaSpahiu #mionistreshendetesie #VizionPlus

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:...**

**Xhuljana Zhuleku** 29 minuta më parë




POLITIKË

**"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja...**

**Xhuljana Zhuleku** Dje 21:49



POLITIKË

**"Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo...**

**Xhuljana Zhuleku** Dje 20:03

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.